

**Mbushja e hapësirës negative:**

**Integrim i temave të raportimit të qëndrueshmërisë në programet arsimore të kontabilitetit financiar të sektorit publik**

**Seanca 2 KP-E / Takimi IX i përbashkët i Komuniteteve të Praktikës të Edukimit dhe Raportimit Financiar**

**Peter C. Lorson (Universiteti i Rostokut)**

**Kryesisht mbështetur në Hines (1988; 1992) & Manes-Rossi et al. (2023)**

## Qasjet ndaj integritit të temave të raportimit të qëndrueshmërisë në programet arsimore të kontabilitetit financiar të sektorit publik

- **Teoria kontabël (kritike)** → ndër të tjera **HINES**
- **Zhvillim (i ri) në vendosjen e standardeve** → ndër të tjera **BSNKSP**
- **Zhvillime (të reja) në fushën e raportimit**
  - ndër të tjera Manes Rossi, F./Brusca, I./Cohen, S./Lorson, P. C. (2023): Raportimi alternativ dhe formatet e kontabilitetit jofinanciar, në: Lorson, P.C./Jorge, S./Haustein, E. (2023, Ed.): Kontabiliteti në Sektorin Publik Evropian, botimi II, Coimbra – shikim i hapur <https://doi.org/10.14195/978-989-26-2464-8> ; f. 506-534

## Motivimi

- Rezultatet financiare (pra pasqyrat financiare) mund të jenë produkt i veprimeve dhe vendimeve pak a shumë të qëndrueshme. Pra, nevojitet transparencë mbi lidhjet mes aspekteve financiare dhe qëndrueshmërisë për realizimin e kontabilitetit (dhe të dobisë për vendimet)
- Raportimi i qëndrueshmërisë është kryesor dhënien llogarinë përpara qytetarëve. Por raportet e qëndrueshmërisë mund të pësojnë të njëjtin fat si të raporteve financiare: lumi i informacioneve mund t'i hutojë përdoruesit dhe për rrjedhojë mund të mos përdoren

### Me rëndësi:

- Raportimi i qëndrueshmërisë ka rëndësi;
- Nevojat për informacion të qëndrueshmërisë mund të lindin dhe raportohen në mënyra të ndryshme.

## PROGRAMI

- 1 • Motivimi
- 2 • **Teoria e kontabilitetit (kritike)**
- 3 • Zhvillime të reja në vendosjen e standardeve
- 4 • Zhvillime të reja në fushën e raportimit
- 5 • Përmbledhje dhe diskutim

## Teoria e kontabilitetit (kritike) (Hines 1988)

- Hines shpjegon: “Kontabiliteti financiar: kur komunikojmë realitetin, e ndërtojmë realitetin” (“Kontabiliteti, organizatat dhe shoqëria”, vol. 13, nr. 3, f. 251-261, 1988)
- Dialog
  - mes një pedagogu (P) dhe një studenti (S)
  - kur vështron një luginë me drurë aq sa të sheh syri dhe një lumë i cili rrjedh nëpër një zonë të madhe të rrethuar me gardh, brenda së cilës ka godina, makineri dhe njerëz
- Një temë madhore:
  - Çfarë mbulon kontabiliteti financiar (dhe si) dhe
  - Çfarë nuk përfshihet në pasqyrat financiare të përgjithshme?

## Teoria e kontabilitetit (kritike) (Hines 1988)

S: Po lumi? Uji i lumit përdoret në procesin e prodhimit!

P: Nga lumi vjen uji i nevojshëm për prodhimin, por nuk është pjesë e organizatës, me përjashtim të rastit kur shitet, dhe atëherë lumi mund të ishte pjesë e emrit të mirë të paguar.

S: Aha, uji qenka emri i mirë? Pra, uji i lumit u bëka “aktiv” kur organizata shitet dhe bëhet kështu pjesë e organizatës së vërtetë.

...

P: E sheh bojën kafe në ujin e lumit pasi kalon uzinën? Është ndotje! A është pjesë e organizatës?

S: Një qytetar i zakonshëm do të kishte po. Por jo kontabilisti?

P: Dikur, po. Sa kohë që kishte mungesë vetëdijesimi për përgjegjësinë e organizatës

lidhur me ndotjen mjedisore. Por sot është ndryshe, sepse organizata tashmë jep llogari për këtë.

....

P: Sa më i madh është prodhimi, aq më i madh është ndotja.

S: Në qoftë se njerëzit e “kuptojnë” ndotjen si pjesë të organizatës, do të duhej të “matej”. Po, si? Nuk i kushton asgjë organizatës. Të tjerët paguajnë.

....

P: Do të gjejmë diçka. Por duhet konsensus. Për aq kohë sa ne kontabilistët do të grindemi për matjen e duhur, njerëzit nuk do t’u zënë besë raporteve tona.

## Teori e kontabilitetit (kritike) (Hines 1992) – Mbushja e hapësirës negative

**Terminologjia:** Hapësira negative, këtu, do të thotë tema e qëndrueshmërisë

- Hapësira pozitive është tema kryesore → pamja që japin pasqyrat e përgjithshme financiare
- Zona e hapësirës negative:
  - rreth temës kryesore
  - nuk perceptohet drejtpërdrejt → kushtet e qëndrueshmërisë
  - nuk tërheq shumë vëmendje, rrethon hapësirën pozitive dhe e mbron → nuk përfshihet në pasqyrat financiare të përgjithshme

**Arsyet për mospërfshirjen historikisht të çështjeve të qëndrueshmërisë nga pasqyrat financiare të përgjithshme**

- Problemet e matjes së duhur: mundësia për të qenë objektive, për të qenë e matshme, për të

qenë e vlerësueshme në formë sasiore, për t'iu matur vlera monetare

- Marrëdhëniet janë të paqarta, jo plotësisht të ditura dhe/ose ndryshojnë me kalimin e kohës (afatshkurtër, afatmesme, afatgjatë)

**Çfarë përfundimesh mund të nxjerrin nga argumentet e Hinesit**

- Çështjet e qëndrueshmërisë janë thelbësore për të kuptuar tërësisht se si realizohet pamja që japin pasqyrat financiare të përgjithshme.
- Duhet të jenë në fakt në ballë të kontabilitetit publik, duke qenë se këtu zbulohet performanca e vërtetë dhe përmushja e vërtetë e detyrës në lidhje me mirëqenien e publikut / të mirën e përbashkët
- Kryesisht përfshihen në raporte më vete ose në raportet shoqëruese

## PROGRAMI

1

- Motivimi

2

- Teoria e kontabilitetit (kritike)

3

- **Zhvillime të reja në vendosjen e standardeve**

4

- Zhvillime të reja në fushën e raportimit

5


- Përmbledhje dhe diskutim



## Zhvillime të reja në vendosjen e standardeve → BSNKSP

- Pasqyrat financiare për qëllime të përgjithshme (PFQP) → SNKSP-të
- Raportimi financiar për qëllime të përgjithshme (RFQP)
  - SNKSP-të + UPR-të
  - Udhëzime të praktikës së rekomanduar (UPR)
    1. Raportimi mbi **qëndrueshmërinë afatgjatë** të financave të njësisë ekonomike
    2. Diskutimi dhe analiza e pasqyrave financiare
    3. Raportimi i informacioneve mbi performancën e shërbimeve

[Reporting Sustainability Program Information - Amendments to RPGs 1 and 3: Additional Non-Authoritative Guidance](#)



## PROGRAMI

- 1 • Motivimi
- 2 • Teoria e kontabilitetit (kritike)
- 3 • Zhvillime të reja në vendosjen e standardeve
- 4 • **Zhvillime të reja në fushën e raportimit**
- 5 • Përmbledhje dhe diskutim

## Mjedisi i raportimit dhe zhvillimet e fundit

- **Jofinanciar do të thotë raportim i qëndrueshmërisë** (Manes-Rossi et al. (2023)):

... përmbajtja e raporteve jofinanciare mund të karakterizohet nga perspektivat ose dimensionet e qëllimeve të përshkruara në to:

- tradicionale: shoqërore, ekologjike, → 3 P-të/PPP (populli, planeti, përfitimi)
  - tashmë mbizotërojnë: MSQ (mjedisore, sociale, qeverisje) ose
  - OZHQ-të e OKB-së: 5 P-të (populli, planeti, prosperiteti, paqja dhe partneriteti)
- **Raportim i integruar** do të thotë **të lidhësh informacionin e qëndrueshmërisë me PFQP-të** (p.sh., midis kapitaleve/burimeve; shih më poshtë)

## Mjedisi i raportimit dhe zhvillimet e fundit – formatet kryesore

(Manes-Rossi et al. (2023))

- Raporti jofinanciar ose i qëndrueshmërisë apo pasqyra e kapitalit intelektual ...** – këtu gjendet një udhëzues në Baden-Vyrtemberg/Gjermani – pjesë nga fusha e veprimit dhe treguesit kyç të performancës të lidhur me të

**A: Ecological sustainability**

- Climate protection and energy transition
- Sustainable mobility
- Natural resources

**B: Economy and Social Affairs: Good life in municipalities**

- Sustainable economy and work
- Social, healthy and safe city/municipality
- Culture and education
- Family friendliness and a balanced population development
- Coexistence, integration and equality

**C: Framework conditions for sustainable municipal development**

- Framework for sustainable, future-oriented sustainable municipal development
- Municipal sustainability management
- Fiscal sustainability
- Citizen participation
- Citizen engagement
- Inter-municipal cooperation
- Global responsibility

**Field of action: municipal sustainability management**

- C1 Good municipal energy management
- Energy consumption of municipal properties
  - per square meter of used space in kilowatt hours
- C2 Sustainable municipal procurement
- Proportion of recycled paper in paper consumption of municipal facilities in percent

**Field of action: Fiscal sustainability**

- C3 Healthy structure of the public budget
- Municipal debt per inhabitant

**Field of action: Citizen participation**

- C4 High level of democratic commitment
- Voter turnout in elections for municipal representation and mayoral elections in percent
- C5 High level of civic participation
- Number of citizens' meetings according to municipal regulations

**Field of action: Civic engagement**

- C6 High level of voluntary commitment
- Number of registered associations per 1,000 inhabitants and inhabitants

## Mjedisi i raportimit dhe zhvillimet e fundit – formatet kryesore (Manes-Rossi et al. (2023))

- OZHQ-të e OKB-së**  
**raportimi**  
(i progresit)

për disa ose të  
17 Objektivat e  
Zhvillimit të  
Qëndrueshëm  
të OKB-së dhe  
169 nënobjektivat



## Mjedisi i raportimit dhe zhvillimet e fundit – formatet kryesore (Manes-Rossi et al. (2023))

- OZHQ-të e OKB-së raportimi**  
(i progresit)

për disa ose të 17 Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB-së dhe 169 nënobjektivat – këtu struktura e raportimit të progresit për OZHQ-të e Eurostatit



## Mjedisi i raportimit dhe zhvillimet e fundit – formatet kryesore (Manes-Rossi et al. (2023))

- **Raportimi i integruar** → Format i posaçëm: Raport vjetor i integruar popullor
  - Objektivi: Shpjegim i krijimit të vlerës në periudhën afatshkurtër, afatmesme ose afatgjatë për investitorët ose të tjerët
  - Parimet orientuese (p.sh., “materialiteti”; “të qenët konciz”, “besueshmëria dhe plotësia”, “njëtrajtshmëria dhe krahasueshmëria”, “fokusi strategjik dhe orientimi i ardhshëm” dhe sidomos “**lidhja e informacionit**”)
  - Përshkrimi i strategjive dhe veprimeve etj. **në mënyrë tërësore/nga disa perspektiva**, p.sh., duke treguar **lidhjen midis p.sh., PFQP-ve dhe informacionit të qëndrueshmërisë** (Manes-Rossi et al. (2023)) – p.sh., midis **gjashtë kapitaleve/burimeve**
    - KAPITALI **financiar** → KAPITALI **i prodhuar** → KAPITALI **Intelektual**
    - KAPITALI **njerëzor** → KAPITALI **shoqëror** → KAPITALI **natyror**

## Mjedisi i raportimit dhe zhvillimet e fundit – formatet kryesore

(Manes-Rossi et al. (2023))

### • Raportimi i integruar - shembull

- Një njësi e qeverisjes vendore përgatit një raport të integruar për të informuar mbi **strategjitë që ka për nxitjen dhe zgjerimin e transportit publik vendor i cili është me bilanc karbonik zero (këtu: blerja e autobusëve të rinj)**. Kjo ndikon në kapitalet/burimet e mëposhtme:
  - **financiar** (zvogëlohet me koston e blerjes, trajnimit dhe ndryshimit të infrastrukturës),
  - **prodhimi** (zmadhohet me koston e blerjes),
  - **intelektual** (mund të zmadhohet meqë duhen krijuar procese të reja),
  - **njerëzor** (zmadhohet sepse shoferët e autobusëve dhe personeli i mirëmbajtjes fitojnë aftësi të reja; zvogëlohet sepse një pjesë e personelit ekzistues nuk do të nevojitet më),
  - **social** (mund të zmadhohet me krijimin e marrëdhënieve të reja me furnizuesit dhe – të paktën në periudhën afatgjatë – priten rezultate pozitive në shëndetin e qytetarëve),
  - **natyror** (mund të zmadhohet për shkak të uljes së ndotjes së ajrit).


 **Shpjegim i efekteve afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata në krijimin e vlerës**



# Mjedisi i raportimit dhe zhvillimet e fundit – formatet kryesore

(Manes-Rossi et al. (2023))

- Raportimi i integruar i lidhur me OZHQ-të e OKB-së**



## Mjedisi i raportimit dhe zhvillimet e fundit – formatet kryesore (Manes-Rossi et al. (2023))

- **Pasqyrat vjetore financiare popullore (PVFP) → RVFP**

- **PVFP:** PFQP me qytetarin në qendër, në mënyrë që

- të parandalohet tejngopja me informacion dhe mungesa e kuptueshmërisë dhe mospërdorimi dhe mungesa e besimit të politika dhe qeveria,

- të rritet potenciali i ndërgjegjësimit, interesit dhe përdorimit / për të përmbushur llogaridhënien

- Megjithatë, studimi empirik i interesave (nevojat për informacion) të qytetarëve tregon se:

- Informacioni nga PVFP-të nuk përputhet (plotësisht) me interesat e qytetarëve

- Qytetarët

- nuk marrin informacion jofinanciar / mbi qëndrueshmërinë

- presin një raport vjetor i integruar popullor (**RVIP**)

- **RVIP është një lloj PVFP-je, i pasuruar me informacione jofinanciare/qëndrueshmërie (p.sh., mbi progresin e arritur në OZHQ përkatëse të OKB-së)**

## PROGRAMI

- 1 • Motivimi
- 2 • Teoria e kontabilitetit (kritike)
- 3 • Zhvillime të reja në vendosjen e standardeve
- 4 • Zhvillime të reja në fushën e raportimit
- 5 • **Përmbledhje dhe diskutim**

## Integrimi i temave të raportimit të qëndrueshmërisë në programet arsimore të kontabilitetit financiar të sektorit publik

**!!! Integrimi tani është standard - normaliteti i ri !!!**

Kontabiliteti, administrimi dhe raportimi i qëndrueshmërisë mund të integrohen lehtësisht në çdo modul të kontabilitetit.

### Qasjet:

- **Teoria e kontabilitetit (kritike)**
  - zbulon një pikë të vdekur sistematike në PFQP
- **Zhvillimet (e reja) në vendosjen e standardeve**
  - zbulojnë përpjekje të mëdha në zhvillimin e standardeve globale të raportimit të qëndrueshmërisë për sektorin publik
- **Zhvillimet (e reja) në fushën e raportimit**
  - zbulojnë një gamë të gjerë qasjesh për raportimin e qëndrueshmërisë (mbase në lidhje me PFQP-të
  - raportimi i integruar – mbështetur në disa ose të gjitha OZHQ-të e OKB-së; të fokusuar te qytetarët ose jo;

**KUJDES / nuk ilustrohet:** Zhvillimet në sektorin privat (ndër të tjera, rritja e kërkesës së investitorëve për informacion të qëndrueshmërisë; vendosja e standardeve në Bashkimin Evropian ose nën mbikëqyrjen e Fondacionit të SNRF-ve; etj. etj. etj.)

## DISKUTIM

### Faleminderit shumë

- për vëmendjen
- për pyetjet dhe komentet e mëpasshme

#### Prof. Dr. Peter Lorson

Universiteti i Rostokut

Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Sociale

Kryetar i Katedrës së Kontabilitetit Financiar,

Kontabilitetit të Drejtimit, Kontrollit

Administrativ dhe Auditimit

Ulmenstrasse 69

18057 Rostock, Gjermani

Email: [peter.lorson@uni-rostock.de](mailto:peter.lorson@uni-rostock.de)



- **Materialet mbështetëse**

- **Ruth D. Hines** → (1988), [https://doi.org/10.1016/0361-3682\(88\)90003-7](https://doi.org/10.1016/0361-3682(88)90003-7));  
→ (1991), <https://doi.org/10.1108/09513579110144802>);  
→ (1992): [https://doi.org/10.1016/0361-3682\(92\)90027-P](https://doi.org/10.1016/0361-3682(92)90027-P)
- **Manes Rossi, F./Brusca, I./Cohen, S./Lorson, P. C. (2023)**: Alternative reporting and non-financial accounting formats, in: Lorson, P.C. Jorge, S./Haustein, E. (2023) (Ed.): European Public Sector Accounting, 2. Aufl., Coimbra (<https://doi.org/10.14195/978-989-26-2464-8>), S. 506-534
- **Lorson, P.C. Jorge, S./Haustein, E. (2023) (Ed.)**: European Public Sector Accounting, 2. Aufl., Coimbra (<https://doi.org/10.14195/978-989-26-2464-8>) → Revised DiEPSAm-Textbook
- **DiEPSAm**: Projekt i Erasmus+ financuar nga BE “Zhvillimi dhe zbatimi i moduleve të kontabilitetit në sektorin publik” në universitetet e shteteve anëtare të BE-së (14 videoleksione online dhe materiale vlerësimi dhe libër shkollor në anglishte);
  - Faqja e projektit: <https://www.diepsam.uni-rostock.de/>
  - Kursi online (me hyrje të lirë): <https://www.uni-rostock.de/weiterbildung/offene-uni-rostock/onlinekurse/european-public-sector-accounting/>
  - Libri shkollor, botimi I (me hyrje të lirë): <https://www.uni-rostock.de/weiterbildung/offene-uni-rostock/onlinekurse/european-public-sector-accounting/>